

URDHËR
Nr.2, datë 6.1.2010

**PËR KËMBIMIN E DOKUMENTACIONIT DHE INFORMACIONIT NDËRMJET ZYRAVE
VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME DHE SEKSIONEVE
TË ADMINISTRIMIT DHE MBROJTJES SË TOKËS NË KËSHILLAT E QARQEVE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 3, 6 dhe 7 të ligjit nr.8752 datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave të administrimit dhe mbrojtjes së tokës” dhe pikës 4, 12 dhe 14 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.532, datë 31.10.2002 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga seksionet e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki”,

URDHËROJMË:

1. Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP) t’u rikthejnë seksioneve të administrimit dhe mbrojtjes së tokës së qarqeve (SAMT) të gjitha planimetritë kadastrale origjinale, planshetat e hartave kadastrale dhe librat e ngastrave të disponuara prej tyre, të cilat u janë dorëzuar nga ish-zyrat e kadastrës (aktualisht SAMT e qarkut) koordinatorëve të sistemit të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme ose direkt ZVRPP, në zbatim të urdhrit të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit nr.511, datë 1.12.1995 “Për dorëzimin e akteve të pronësisë dhe përdorimit të tokës bujqësore koordinatorëve të rretheve të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Për nevoja pune, ZVRPP-të mbajnë fotokopjet e tyre.

Dorëzimi të bëhet me procesverbal dhe të përfundojë brenda muajit qershor 2010.

2. ZVRPP t’i ofrojë SAMT-së së qarkut të gjitha kopjet e hartave treguese të regjistrimit (HTR) dhe librave të ngastrave (LN) në formë elektronike dhe/ose manuale.

Fotokopjimi i HTR-ve dhe LN-ve të bëhet në ambientet e ZVRPP-së, brenda muajit qershor 2010.

3. SAMT-ja e qarkut të caktojë një punonjës të tij, të pajisur me autorizim të kryetarit të këshillit të qarkut për fotokopjimin e dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2 të këtij urdhri sipas kërkesës që bëjnë zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës (ZMMT) në komuna dhe/ose bashki.

Të gjitha shpenzimet për marrjen e këtij dokumentacioni mbulohen nga buxheti i këshillit të qarkut.

4. ZVRPP-ja e rrethit, sipas formatit të pasqyrës që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe si pjesë përbërëse e tij, brenda datës 30 qershor dhe 31 dhjetor të çdo viti përgatit evidencën 6-mujore të shitblerjeve të tokës bujqësore (arë, pemëtores, vreshta, ullishte) dhe ia dërgon SAMT-së së këshillit të qarkut.

SAMT e këshillit të qarkut, brenda datës 15 korrik dhe 15 janar të çdo viti, i dërgon MBUMK-së evidencën përmbledhëse, 6-mujore të shitblerjeve të tokës bujqësore.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ZVRPP në rrethe, SAMT në këshillat e qarqeve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së
Konsumatorit
Genc Ruli

Ministri i Drejtësisë
Bujar Nishani

ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Evidenca e shtiblerjeve të tokës bujqësore (arë, pemëtoje, vreshta, ullishte)

Nr.	Emërtimi i komunës/bashkisë ku është kryer transaksioni i tokës	6-mujori i parë Viti_____				Progresi vjetor Viti_____			
		Nr. i transaksioneve	Sipërfaqja objekt transaksionit m ²	Çmimi mesatar në shkallë komune lekë/m ²	Vlefëta lekë	Nr.transaksioneve	Sipërfaqja objekt transaksionit m ²	Çmimi mesatar në shkallë komune lekë/m ²	Vlefëta lekë
1									
2									
3									
4									
5									
6									
7									
8									
9									
10									
11									
12									
13									
14									
15									
	GJITHSEJ RRETHI								